



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore Pjetër Shala, Trupi Gjykuar ka caktuar shpalljen e aktgjykimit më 16 korrik, në orën 14:00.

Seanca do të jetë publike dhe mund të përcillet në shqip, anglisht dhe serbisht përmes faqes së internetit të DHSK-së (<https://www.scp-ks.org/sq/transmetim>) me një vonesë të vogël.

Në këtë çështje gjyqësore, Prokurori pretendon se përafërsisht mes 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, Pjetër Shala dhe disa ushtarë, policë dhe roje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, morën pjesë në ndalimin arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe në një rast në vrasjen e paligjshme të një të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës, në veri të Shqipërisë.

Sipas Aktakuzës, viktimat e këtyre krimeve ishin persona për të cilët dyshohej se bashkëpunonin me Serbinë ose nuk përkrahnin UÇK-në, dhe të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime. Në procesin gjyqësor morën pjesë tetë viktima të përfaqësuar nga një avokat.

Në Aktakuzë thuhet se të ndaluarit në fabrikën e metalit u keqtrajtuan rregullisht, qoftë fizikisht, ndër të tjera përmes rrahjes me mjete të ndryshme, ashtu edhe psikologjikisht, përmes kërcënimit me vdekje, poshtërimit, ngacmimit, marrjes në pyetje ose dhënies së deklaratave dhe pranimit të detyruar nën shtrëngim.

Në Aktakuzë pretendohet se Pjetër Shala kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në krimet e pretenduara, përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë dhe mosmarrjes së masave adekuate për të mundësuar trajtimin njerëzor të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës, dhe duke ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve për të cilat u ngritën akuzat.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit* Bislim Zyrapi vazhdoi dëshminë e tij këtë javë me pyetjet nga ekipet e Mbrojtjes. Ai dha dëshmi gjatë gjithë javës dhe dëshmia e tij do të vazhdojë të hënën, 15 korrik, në orën 9:00 të mëngjesit. Ndërkohë, sot filloi dhënien e dëshmisë një dëshmitar tjetër, përmes videolidhjes. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë që u lexua në sallën e gjyqit, ky dëshmitar u arrestua dhe u mbajt i ndaluar nga anëtarë të UÇK-së në vitin 1998.





Përpara fillimit të seancës në këtë çështje më 8 korrik, zotit Krasniqi iu kërkua të hiqte kravatën. Meqë ky veprim ka tërhequr vëmendjen e medias, do të dëshiroja të sqaroja edhe një herë atë që u komunikua me herët gjatë kësaj jave.

Përpara seancës më 8 korrik, shërbimi i sigurisë së DHSK-së i kërkoi z. Krasniqi të hiqte kravatën derisa të merrnin sqarim nga shefi i paraburgimit nëse rregullat e paraburgimit për ndalimin e disa veshjeve kishin zbatim në këtë rast.

Kravata iu kthye z. Krasniqi po atë ditë dhe shefi i paraburgimit konfirmoi se lejohej mbajtja e kravatës.

Në lidhje me të njëjtën çështje gjyqësore do të doja të trajtoja disa artikuj të pasaktë në media lidhur me vizitat dhe komunikimet me anëtarët e familjeve të të akuzuarve në objektin e paraburgimit.

Në dhjetor 2023, Trupi Gjykes vendosi disa kufizime për vizitat dhe komunikimet që vlejné vetëm për tre nga të akuzuarit: Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin. Kjo u bë për të mbrojtur dëshmitarët pasi Prokuroria dorëzoi transkripte të komunikimeve mes tre të akuzuarve dhe vizitorëve të tyre, ku duket se të akuzuarit u dhanë vizitorëve të tyre informacion konfidencial lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur. Në rastin e z. Thaçi, transkriptet sugjerojnë se ai i dha një vizitori udhëzime për një dëshmitar të ardhshëm të ZPS-së, lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë së ardhshme të atij dëshmitari.

Sa u përket vizitave dhe komunikimeve, DHSK-ja dëshiron të theksojë se, pavarësisht disa kufizimeve të vendosura nga Trupi Gjykes për këta tre të akuzuar, të gjithë të paraburgosurve u lejohen ende 10 ditë vizitash në një periudhë prej 30 ditësh dhe se vizitat dhe komunikimet me bashkëshortet dhe fëmijët nuk janë kufizuar apo reduktuar.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 5 korrik, Trupi Gjykes vendosi të riklasifikonte disa pjesë të dëshmimeve të dy dëshmitarëve si publike dhe urdhëroi përgatitjen e versioneve me më pak redaktime të transkripteve nga seancat përkatëse. Kjo vjen në vijim të urdhrin të gjykatësve për rishikimin e transkripteve konfidenciale, në dobi të garantimit sa më shumë që të jetë e mundur të parimit të procesit publik.

Seancat në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, rifillojnë të hënën e ardhshme, më 15 korrik, në orën 9:00 të mëngjesit.

Në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, më 8 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi ndryshimet në aktakuzën e përbashkët.

Ndryshimi kryesor i konfirmuar shton në akuzat kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari akuzën e frikësimit përmes premtimit ose dhuratës, siç përkufizohet në Kodin Penal të Kosovës. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se materialet mbështetëse tregonin se gjatë kontaktimit të dytë të një dëshmitari më 12 prill 2023,





z. Januzi përmendi dëshminë e dëshmitarit dhe shpjegoi se, sipas Haxhi Shalës, dëshmitari ishte dëshmitar kundër Rexhep Selimit.

Sipas materialit mbështetës, z. Januzi përcolli një mesazh nga z. Shala, gjegjësisht se, në qoftë se ekzistonte mundësia që dëshmitari të pajtohej të tërhiqte dëshminë e tij kundër z. Selimi, atëherë z. Shala dhe të tjerë “ishin të gatshëm t’i përmbushin çfarëdo nevoje [dëshmitarit 1]” ose e thënë ndryshe, “ai [dëshmitari 1] na ndihmon ne dhe ne [z. Shala dhe të tjerë] ndihmojmë atë.”

Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi Prokurorinë të dorëzonte versionin e përditësuar të aktakuzës brenda 10 korrikut.

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave të DHSK-së, nëse aktakuza e ndryshuar përfshin akuza të reja, atëherë i akuzuari duhet të dalë përsëri para gjykatësit për paraqitje vijuese. Meqë pretendimet e reja faktike ishin pjesë e aktakuzës fillestare kundër Haxhi Shalës edhe më parë, prania e tij në seancë nuk nevojitet. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka caktuar seancë për paraqitjen vijuese të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit, për këtë të premte, 12 korrik në orën 09:30. Seanca do të jetë publike. Më shumë informacion për aktakuzën e ndryshuar në këtë çështje gjyqësore gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

